

HALKBANK

Të rëndësishëm janë njerëzit! E këtë HalkBank e ka seriozisht

Halkbank krijon dhe mbështet vlera që avancojnë çdo aspekt të jetës shoqërore. Kur njerëzit kishin një problem, HalkBank ishte aty me zgjidhje kreative dhe ekologjike, duke angazhuar njerëzit të përballen me një problem të përgjithshëm. E ky hap i HalkBank ishte një mësim edhe për kompanitë tjera që të ndjekin hapin e tyre.



Rreth HalkBank:

HalkBank është një nga markat më të mëdha dhe më të fuqishme në tregun financiar në Maqedoni. Vetë funksionimi i Halkbank, fakti që është banka me rritjen më të shpejtë dhe pjesë e grupit të pesë bankave më të mëdha dhe me rëndësi sistematike në vend, rritja e vazhdueshme e kapitalit nga viti në vit, rritja e madhe si e kredisë dhe bazës së depozitave, janë dëshmia më e mirë e stabilitetit dhe prosperitetit, por edhe e besimit të madh që qytetarët dhe subjektet afariste kanë në markën tonë.

Si një institucion financiar modern, Halkbank ndjek vazhdimisht zhvillimin e tendencave të reja teknologjike dhe informatike dhe i zbaton ato në përputhje me gamën tashmë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve në dispozicion. Numri i madh i produkteve dhe shërbimeve inovative kontribuon që Halkbank të jetë lidere e e-bankingut në vend. Në periudhën e kaluar janë krijuar platforma dhe shërbime që u mundësojnë qytetarëve dhe personave juridikë që detyrimet e tyre të përditshme bankare t'i kryejnë në mënyrë të shpejtë, të sigurt dhe të thjeshtë.

Halkbank me punën e deri tanishme ka përcaktuar drejtimin drejt të cilës po ecën, që është ndjekja e zhvillimit teknologjik dhe zbatimi maksimal i risive me qëllim të përmirësimit të produkteve dhe shërbimeve, njëashtu krijimit të produkteve dhe shërbimeve të reja. Motoja “Të rëndësishëm janë njerëzit” flet edhe për përkushtimin e vazhdueshëm të Bankës ndaj klientëve, punonjësve, partnerëve dhe njerëzve në përgjithësi, me shërbim cilësor dhe ndërtimin e një partneriteti afatgjatë me klientët dhe bashkëpunëtorët.

Në të njëjtën kohë, Halkbank njihet në vend si një nga kompanitë më të përgjegjshme shoqërore, e cila kujdeset për komunitetin dhe investon në mënyrë të përhershme në mbrojtjen e mjedisit, ndihmon në realizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore, në projekte që do të thotë mbështetje për të rinjtë, arsimin, artin, temat sociale dhe në zhvillimin e sektorit real”.

Gjatë bisedës me zyrtarët e bankës, na treguan që janë krenar për shumë projekte të zhvilluara në ndihmë të shoqërisë por më shumë shprehën interesim për të folur rreth nismës, aplikacionin celular HalkEco, që ndryshe njihet edhe si tentim i përbashkët i bankës dhe qytetarëve për pyllëzimin e vendit.



Ndotja e ambientit dhe ajri i ndotur është një problem i kahmotshëm në Maqedoni dhe në Ballkan. Një problem që nxiti reagimin e publikut dhe institucioneve për tu përballur me problemin që për vite ishte anashkaluar. Problemi i ndotjes së ajrit ishte i injoruar edhe nga kompanitë që në një formë ishin edhe të apostrofuara edhe nga publiku për mos-reagim ndaj këtij problemi. Shteti kërkoi ndihmë nga qytetarët por edhe nga kompanitë për të gjetur zgjidhje për ngrohjen gjatë stinës së dimrit, duke ju apeluar që mos përdoret druri si zgjidhje për ngrohje. Që mos rritet ndotja dhe mos priten drunjtë, që shërbejnë edhe si pastrues të ajrit. Dhe në mesin e disa kompanive, që ju përgjigj kërkesës së shtetit ishte edhe HalkBank, duke ofruar aplikacionin HalkEco, si një ndër zgjidhjet për të përmirësuar ambientin dhe ajrin, duke i angazhuar qytetarët dhe klientët e saj.

Problemi i ndotjes së ajrit i shfaqet Maqedonisë së Veriut çdo vit. E aplikacioni i krijuar nga HalkBank e jep një ndihmë në përballjen me këtë problem, duke i mundësuar rritjen e kapaciteteve ekologjike. Mushkëritë e natyrës janë drunjtë, ndërsa projekti i HalkBank është ripërtritja e tyre, duke mbjellë sa më shumë drunj në vende ku me të vërtetë duhet. Si zgjidhje dytësore nga ky aplikacion është edhe përballja me prerjen ilegale të drunjve. Të mbjellësh një dru do të thotë të mbjellësh një pastrues natyral të ajrit.

HalkEco ishte dhe është përballje dhe luftë me realitetin e atëhershëm, por edhe sot: Ndotja e ambientit dhe ajri i papastër. Më poshtë do të jenë të gjithë detajet se si ka ndikuar zgjidhja e HalkBankës për të përmirësuar jetën e qytetarëve.

Halkbank Sh.A Shkup, si kompani, strategjia e së cilës për përgjegjësi shoqërore korporative bazohet pikërisht në ngritjen e vetëdijes për çështjet mjedisore, tashmë në tetor të vitit 2019 krijoi aplikacionin celular HalkEco me të cilin me një sërë dhuratash dhe përfitimesh motivon qytetarët të ecin, vrapojnë ose ngasin biçikletën.

Në këmbim, Halkbank mori përsipër të mbjellë pemë për çdo 80 kilometra të përshkuar në këto aktivitete, si një aktivitet kumulativ i të gjithë përdoruesve të aplikacionit. Deri më tani në këtë mënyrë janë siguruar gati 13 mijë fidanë dhe emetimi i CO2 është ulur me më shumë se 131400 kg.



Që nga aksioni i parë i mbjelljeve të mbajtur më 26 tetor 2019, Halkbank ka organizuar një sërë aksionesh të mëdha dhe të vogla të mbjelljes së pemëve të reja. Kështu, në oborret e shkollave në Shkup, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Kërçovë dhe Bogdanci u mbollën 220 fidanë, me 6000 fidanë të rinj, u rinovua fondi i drurit në rrethinën e liqenit të Velesit ku më parë kishte një zjarr të fuqishëm në pyll, kurse 2790 fidanë ishin mbjellë në zonën ndërmjet Manastirit dhe Demir Hisarit. Aksionet vazhduan me mbjelljen e 9200 pemëve në rrethinën e Kumanovës, ndërsa në rrethinën e Shën Nikollës janë mbjellë gati 16.000 pemë dy herë të siguruara nga fondet e Bankës, por edhe me paratë e mbledhura nga taksat e paguara të regjistrimit të pjesëmarrësve në Garat e biçikletave Halk Velo Green, të cilat tashmë dy vite me radhë organizohen në Mavrovë nga ana e Bankës. Përveç këtyre aksioneve më të mëdha, pemë të reja u mbollën edhe në oborrin e NP Lajka dhe në disa lokacione të tjera. Në total, mbi 35 mijë fidanë të rinj të mbjellë në disa lokacione në vend është kontributi që kemi dhënë deri tani për rritjen e fondit pyjor” thonë zyrtarët e bankës.

“HalkEco sot është tashmë një platformë përmes së cilës ne ndihmojmë në rregullimin e zonave të gjelbra dhe krijimin e hapësirave urbane eko. Me mbështetjen tonë janë rinovuar urat në parkun e qytetit në Shkup, kemi rregulluar një kënd të gjelbër në qendrën tregtare Leptokaria në Shkup dhe të njëjtën gjë kemi bërë në Gostivar, në komunën e Aerodromit kemi bërë një çati të gjelbër në një stacion autobusi, në Krushevë kemi rinovuar një urë, në Tetovë dhe Ohër kemi rregulluar kënde lojërash eko gjithëpërfshirëse në shkollat fillore etj. Sigurisht që do të vazhdojmë me praktika të tilla të gjelbra edhe në të ardhmen” thonë nga HalkBank.

Ky aplikacion u vlerësua zyrtarisht duke marrë çmimin për praktikën më të mirë shoqërore për mjedisin nga ana e Ministrisë së Ekonomisë.



Të rëndësishëm janë njerzit!



Përveç HalkEco, HalkBank ka kontribuar në shoqëri edhe me dhjetëra projekte që tashmë janë duke u shfrytëzuar nga qytetarët dhe shoqëria. Mbështetja për garat sportive, ndërtimi i një murali të madh në Mavrovë me rastin e Ditës së Planetit Tokë, mirënjohja e pranuar për "Librin me fotografi të Halki" nga Shoqata Maqedonase e Botuesve për nxitjen e përgjegjësisë sociale, çmimi për praktikën më të mirë shoqërore për Halkeko nga Ministria e Ekonomisë, donacione në interes të mjedisit dhe shoqërisë, mbështetje për kulturën, edukimin për të rinjtë, shpërblimet e siguruara për përdoruesit e aplikacionit HalkEco... Këto janë vetëm disa nga aktivitetet me përgjegjësi shoqërore të Halkbank AD Skopje që nga fillimi i vitit, i cili me siguri do të jetë edhe një vit i mbushur me mbështetje për projekte dhe aktivitete të shumta. Halkbank njihet në vend si një mbështetëse e madhe e kulturës, sportit, fëmijëve dhe të rinjve, gjithëpërfshirjes, nxitëse e kultivimit të shprehive të shëndetshme të jetesës dhe mbrojtjes së natyrës.

Halkbank nxit vlera që avancojnë çdo aspekt të jetës shoqërore. Këto vlera bazohen në kushtet dhe proceset shoqërore në jetën sociale dhe kulturore, të cilat ne përpiqemi t'i mbështesim në çdo mënyrë të mundshme dhe të ndihmojmë në ngritjen e tyre në një nivel më të lartë në jetën shoqërore. Pjesë si përgjegjësi dhe detyrim ndaj komunitetit, por shumë më tepër si besimi ynë, një filozofi që mund të ndryshojë jetën, të japë cilësi shtesë dhe të hapë një perspektivë të re. Nga ky besim, ne kemi krijuar një praktikë të përgjegjësisë korporative në formën e mbështetjes së projekteve dhe eventeve të ndryshme kulturore, arsimore dhe sportive, si dhe atyre që synojnë mbrojtjen e mjedisit, sepse kështu rritet e mira e përbashkët. Angazhimi për promovimin e këtyre vlerave është gjithashtu në përputhje me platformën tonë të korporatës "Të rëndësishëm janë njerëzit", e cila i identifikon dhe njeh të gjithë si individë të rëndësishëm.



HALKBANK

24